

A DUHET TË FOTOGRAFONI DHE SHPËRNDANI NË RRJETET SOCIALE KARTËN TUAJ TË VAKSINËS?

Ndarja e një fotoje të kartës tuaj të vaksinës kundër COVID-19 në mediat sociale është trendi i momentit. Kjo i tregon të gjithëve që keni bërë të paktën një dozë të vaksinës. Por ju mund të dëshironi ta mendoni dy herë para se të ngarkoni dhe ndani provën tuaj të vaksinimit. Better Business Bureau paralajmëroi kundër kësaj ideje para disa kohësh sepse ka informacion të vetëidentifikimit në kartë.

Nëse nuk jeni të kujdesshëm, kjo mund ta bëjë më të lehtë për njerëzit që të vjedhin identitetin tuaj ose të ndihmojë mashtruesit të krijojnë versione false të kartës së vaksinës. Mbani në mendje se karta juaj e vaksinimit përfshin informacione personale si emrin tuaj të plotë, ditëlindjen, llojin e vaksinës dhe vendndodhjen ku keni marrë vaksinën tuaj.

KËTO JANË SHUMË NGA INFORMACIONET E NEVOJSHME PËR FALSIFIKIME TË MUNDSHME

Better Business Bureau, gjithashtu raporton se p.sh. në Britaninë e Madhe janë kapur mashtrues duke shitur karta false të vaksinimit në eBay dhe TikTok. BBB thotë se është vetëm çështje kohe para se mashtruesit të përpiqen të fillojnë të bëjnë të njëjtën gjë edhe në shumë shtete të tjera.

BBB OFRON DISA IDE TË SIGURTA PËR T'U TREGUAR TË TJERËVE SE KENI BËRË NJË VAKSINË

- Nëse merrni një broshurë, pasi keni bërë vaksinën, ndani më mirë një fotografi të saj.
- Vendosni një kornizë rreth fotos së profilit tuaj në Facebook, që dëshmon se jeni vaksinuar.
- Rishikoni cilësimet e sigurisë në të gjitha llogaritë tuaja të mediave sociale për t'u siguruar që vetëm njerëzit që dëshironi të shihni llogarinë tuaj do ta shohin atë.
- Bëni kujdes nga kuicet në Facebook. BBB thotë se ato mund të mbledhin informacione që shpesh mund të përdoren si fjalëkalime ose pyetje sigurie.

Ky dokument është përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në kuadrin e projektit " COVID-19, Reagim Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar", të mbështetur financiarisht nga Ballkan Trust for Democracy(BTD). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e BTD.

Për të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe Covid-19, ju mund të lexoni materialet e publikuara në faqen tonë : <https://platforma-pak.al/te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-covid-19/>, ku keni dhe hapësirën e posaçme dedikuar për pyetjet tuaja.